



6/4 KBU
17.5.24

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASENIT UJOR ERZEN

VENDIM

Nr.2, datë 30/04/2024

PËR

MIRATIMIN E KËRKESËS “PËR RINOVIMIN E KUSHTEVE TË LEJES/AUTORIZIMIT”, LEJE ME NR.SERIE 00031 MIATUAR ME VENDIM NR.12, DATË 20.06.2019, SUBJEKTI “SALILLARI” SH.P.K

Në mbështetje të pikës 2, nenit 50, të ligjit nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, të ndryshuar, vendimit nr.550, datë 15.7.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli i Basenit Ujor Erzen,

V E N D O S I:

1. Miratimin e kërkesës për rinovimin e lejes për përdorim burimi ujor nëntokësor për qëllime teknologjike, Leje me Nr.serie:00031, miratuar nga KBU Ishëm-Erzen me Vendim Nr.12, datë 20.06.2019, subjektit “SALILLARI” sh.p.k, me vendndodhje, Bashkia Vorë, Qarku Tiranë sipas këtyre koordinatave:
2. Treguesit paraprak janë si më poshtë:

Vendndodhja e përcaktuar e pus-shpimit (KRGJSH)

- $X=470236.18$
- $Y=4584625.50$
- $Z=87$ m.m.n.d

- Prurja mesatare: $Q_{mes}=2.5$ l/sek
- Sasia e ujit në përdorim: $Q=2,5$ l/sek
- Qëllimi i përdorimit: Për qëllime teknologjike (Larje inertesh në fabrikën e prodhimit të betonit)
- Shkarkimi i ujërave të përdorur: Përroi i Tones.

3. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas njoftimit të përmbajtjes së vendimit subjektivit.

KRYETARI I KBU ERZEN

AFRIM QËNDRO

